



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:192792
Datë: 07.06.2024
Numri i dokumentit: 05793781

K.DH.SH.II.nr.876/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit “Cima” SH.P.K., me NUI: 810796328, me seli në Prishtinë, rruga “Arberia” Eliza B3, përfaqësuar sipas autorizimit nga I.S., duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1455/23 të datës 27.12.2023, me datën 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Thazir Shala”, nr.4, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1455/23 të datës 27.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1455/23 të datës 27.12.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Cima” SH.P.K”,

me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 225/23, i lejuar më datë 18.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Isa Shala, Anulohet, dhe Detyrohet kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t'ia paguaj debitorit shumën prej 78.00 € (shtatëdhjetë e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e kreditorit ndersa aktvendimi KPPP.nr. 1455/23 të datës 27.12.2023 i shkallës së parë të vërtetohet.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, P.nr. 225/23, i lejuar më datë 18.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Ekstraktit nga Librat Afariste me Nr.K058753 nga periudha kohore 31.10.2020 deri 31.07.2023, duke urdhëruar debitorin "Cima" SH.P.K., që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 545.94 € si dhe shpenzimet e procedurës, në të kundërtën përmbartimi të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat i posedon debitori në llogaritë e tij bankare dhe bartja e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajshme të debitorit dhe bartjen e atyre mjeteve në llogarinë e kreditorit. Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësimin brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin për lejimin e përmbartimit, për faktin se i njëjti është lejuar mbi bazën e një dokumenti i cili nuk ka titull përmbartimor ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të LPP-së.

Tutje ka theksuar se kreditori ka kërkuar borxhin sipas kartelës financiare nga data 01.01.2013 e deri më datë 15.08.2023, një kërkesë e tillë është e parashkruar edhe në rast se borxhi i tillë do të ekzistonte. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të obligohet kreditori që debitorit t’ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimi shumën prej 104.00 €. Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar se pretendimi i debitorit lidhur me Ekstraktin nga Librat Afarist se nuk është dokument i përmbarueshëm, është i paqëndrueshëm për faktin se LPP e njehë si dokument të besueshëm sipas nenit 29 par 1 pika 2 të LPP-së. Tutje ka shtuar se kreditori periudhën e borxhit të kërkuar e ka cekur në propozimin për përmbarim 31.10.2020 deri me 31.07.2023, e që për këtë nuk ka arritur koha e parashkrimit, pasi që në këtë rast vlen periudha e parashkrimit deri në 3 vite. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoi si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.1 nën par. 1.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen: “ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Gjykata e shkallës e parë vlerëson se Ekstrakti nga Librat Afariste me Nr. K058753, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit/kartelës së konsumatorit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitorit.

Tutje kjo Gjykatë deri të ky vlerësim erdhi pasi që Ekstrakti nga Librat Afariste me Nr. K058753 përmban borxhin në shumën prej 545.94 për periudhën 01.01.2013 deri me datë 15.08.2023, mirëpo nuk është paraqitur periudha kohore për të cilën është krijuar ky borxh, përkatësisht nuk është e përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri më datë 31.10.2022 dhe nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri tek borxhi i kërkuar, andaj si rrjedhojë ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qarte se si dokument i besueshëm - Ekstrakti nga Librat Afariste nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore të LPP-

së, sepse borxhi i cili rezulton në shumën prej 545.94 për periudhën 01.01.2013 deri me datë 15.08.2023, mirëpo nuk është paraqitur periudha kohore për të cilën është krijuar ky borxh, përkatësisht nuk është e përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri më datë 31.10.2022 me ç'rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.876/24, me datë 07.06.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti